



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1608/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ramush Bardiqi, kryetar i kolegjit, Krenar Berisha dhe Dren Rogova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Komuna e Obiliqit me seli në Obiliq, të cilin e përfaqëson N.M. avokat nga Prishtina, kundër të paditurve “Delta Ing” SH.P.K., me seli në Prishtinë, NTP “Bass Com” dhe “Bejta Commerce” SH.A., që të dy me seli në Gjilani, të cilët i përfaqëson R.G., për shkak të kompensimit të dëmit nga përmbushja jo e rregullte e kontratës së ndërtimit, duke vendosur sipas ankesës së autorizuarit të palës paditëse dhe të paditurve, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.333/2018 të datës 14.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 15.02.2024, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

I.**REFUZOHEN** si të pabazuara ankesa e autorizuarit të paditësit Komuna e Obiliqit, me seli në Obiliq.

II.**REFUZOHET** si e pabazuar ankesat e të paditurit të parë “Delta Ing” SH.P.K., me seli në Prishtinë dhe të paditurit të dytë NTP “Bass Com” me seli në Gjilan.

III. **Hedhet Poshtë** ankesa e të paditurit të tretë “Bejta Commerce” SH.A., me seli në Gjilan, si e palejueshme.

IV. **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.333/2018 i datës 14.07.2022.

### A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.333/2018 të datës 14.07.2022, në pikën I të dispozitivit ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Komuna e Obiliqit, e paraqitur kundër të paditurit të parë “Delta Ing” SH.P.K., me seli në Prishtinë, ashtu që i njëjti detyrohet t’ia paguaj paditësit shumën prej 8,197.66 €, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga përmbushja jo e rregullt e kontratës së ndërtimit, me kamatë prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë,

11.07.2018, e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Në pikën II të dispozitivit ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Komuna e Obiliqit, e paraqitur kundër të paditurit të dytë NTP “Bass Com” me seli në Gjilan, ashtu që i njëjti detyrohet t’ia paguaj paditësit shumën prej 56,276.67 €, në emër të kompensimit të dëmit të shkaktuar nga përmbushja jo e rregullt e kontratës së ndërtimit, me kamatë prej 8 % në vit, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë dt.11.07.2018 e deri në pagesën definitive, që të gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit. Në pikën III të dispozitivit ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit Komuna e Obiliqit, të paraqitur kundër të paditurit të tretë “Bejta Commerc” SH.A., me seli në Gjilan, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet i padituri i tretë që t’ia paguaj shumën prej 56,275.67 €, në emër të përmbushjes së pa rregullt të kontratës së ndërtimit. Në pikën IV të dispozitivit secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjorë ka paraqitur ankesë i autorizuari i paditësit për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vetëm sa i përket pikës IV të dispozitivit që ka të bëjë me shpenzime e procedurës, me propozim që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar sa i përket shpenzimeve të procedurës dhe paditësit të i njihen të njëjtat.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjorë ka paraqitur ankesë i padituri i parë “Delta Ing” SH.P.K., për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa, të anulohet aktgjykimi dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ankesë kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjorë ka paraqitur edhe i autorizuari i të paditurit të dytë dhe të tretë, për shkak të shkeljes substanciale të dispozitave ligjore, vlerësimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të anulohet në tërësi dhe çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, pas vlerësimit të ankesave dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesat e paditësit dhe të paditurit të parë dhe të dytë janë të pabazuara.  
Ankesa e paditurit të tretë është e palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi Komuna e Obiliqit, me seli në Obiliq, me datë 11.06.2018, ka paraqitur padi kompensimit të dëmit nga përmbushja jo e rregullte e kontratës së ndërtimit, kundër të paditurve Delta ING” SH.P.K., me seli në Prishtinë, NTP “Bass Com” dhe “Bejta Commerce” SH.A., që të dy me seli në Gjilani. Në padi ndër të tjera ka theksuar se paditësi dhe i padituri i parë “Delta Ing” SH.P.K., në vitin 2013 kanë lidhur kontratë me titull “*Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Breznicë lagja Koskovik dhe në rrugën e fshatit Kozaricë*”, me çmim

prej 44,954.29 €. Po ashtu, paditësi dhe i padituri i dytë “Bass Com” SH.P.K., në vitin 2013, kanë lidhur kontratë me titullin “*Asfaltimi i rrugëve rurale*”, me çmimin prej 150,232.53 €. Gjatë fazës së ekzekutimit të kontratës, NTP “Bass Com”, ka lidhur marrëveshje nën kontraktimi me të paditurin e tretë “Bejta Commerce”, për qëllime të ekzekutimit të kontratës së ndërtimit. Më tutje, ka theksuar se palët e paditura i kanë përfunduar punimet ndërtimore, mirëpo punimet kanë qenë të pa rregullta dhe me të meta, me ç ‘rast i kanë shkaktuar dëm material palës paditësit në vlerë prej 8,197.66 € nga i padituri i parë dhe 56,276.67 € nga të paditurit e dytë dhe të tretë.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar I.EK.nr.333/2018 të datës 14.07.2022, me të cilin e ka miratuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit kundër të paditurit të parë dhe të dytë, ndërsa ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit kundër të paditurit të tretë, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se nuk ka qenë kontestuese në mes palëve në procedurë se paditësi dhe i padituri i parë “Delta Ing” SH.P.K., në vitin 2013, kanë lidhur kontratën me titull “asfaltimi i rrugës Breznicë – Koskovik” me numër të prokurimit 614-12-026-521, në vlerën prej 126,814.16 €, dhe kontratën me titull vazhdimi i asfaltimit të rrugës Breznicë - Koskovik dhe lagjja Kozaricë me numër të prokurimit 614-12-049-521, në vlerën prej 44,954.29 €. Po ashtu nuk ka qenë kontestuese në mes të palëve në procedurë se paditësi dhe i padituri i dytë NTP “Bass Com” me seli në Gjilan, kanë lidhur kontratë të ndërtimit me titullin “*Asfaltimi i rrugëve rurale*” me numër 614-13-014-521, me çmimin 157,942,53 €. Gjithashtu nuk ka qenë kontestuese se i padituri i dytë NTP “Bass Com” me seli në Gjilan, ka bërë marrëveshje nën kontraktimi me të paditurin e tretë “Bejta Commerec” të cilin e ka angazhuar për përmbushjen e kontratës së lidhur me Komunën e Obiliqit, e cila palë ka zhvilluar punimet ndërtimore.

Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike ka administruar provat materiale si procesverbalin e Komisionit të pranimit teknik të datës 20.08.2013 dhe 09.10.2013, mirëpo pas pranimit teknik të punimeve respektivisht me datë 08.07.2014, palët kanë nënshkruar një marrëveshje të përbashkët ku është konfirmuar se rrugët janë të dëmtuara dhe se sanimi i tyre duhet të bëhet nga punëmarrësi. Me këtë dokument palët janë dakorduar se punët ndërtimore kanë qenë me të meta, me vet faktin se kanë konstatuar “dëmtimet” në rrugët e lartpërmendura. Po ashtu nga Raporti Institutit të Materialeve, Ndërtimore dhe Konstruksioneve-IBMS për vlerësim të gjendjes së rrugëve, e i cili Institut ka paraqitur raportin me shkrim për gjendjen e rrugëve të ndërtuara me datë 11.03.2014, i cili ka konstatuar se operatorët ekonomik kanë anashkaluar shumë pika të kontratës, njëra ndër to është se asfalti ka qenë dashur të shtrohet me 8 cm, ndërsa i njëjti është bërë me trashësi mesatare prej 4,71 cm, çka nënkupton se punimet ndërtimore janë kryer me të meta. Gjykata ka arsyetuar se po ashtu edhe nga ekspertet gjyqësorë të ndërtimitarisë N.M. dhe S.B. është vetëtuar se punimet ndërtimore kanë të meta dhe rrjedhimisht kanë prodhuar dëme për palën paditëse, e të cilave ekspertiza gjykata ju ka falur besimin.

Gjykata ka theksuar se ka kërkesëpadia e paditësit në relacion me të paditurin e tretë është e pabazuar, për shkak se këto dy palë ndërgjyqëse nuk kanë qenë farë në raport kontraktues dhe se për tu prodhuar një dëm kontraktues, palët paraprakisht duhet të hyjnë në raport kontraktues, pra palët nuk janë në legjitimacion real në mes vete, prandaj edhe nuk janë prodhuar detyrime kontraktuese në mes tyre.

Gjykata ka arsyetuar se baza e kërkesëpadinë se paditësit gjene mbështetje në nenin 17 dhe 630 të LMD-së. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 277 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosur konform nenit 463.1 të LPK-së.

Gjykata Komerciale–Dhomat e Shkallës së Dytë nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë lidhur me mënyrën e vendosjes sipas aktgjykimit të ankimuar, është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK-së, dhe drejtë është zbatuar e drejta materiale për të cilat shkaqe kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit të parë dhe të paditurit të dytë për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore ngase kjo gjykatë vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është mjaft i qartë, në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye edhe për besueshmërinë e mjeteve provuese me të cilat ka vërtetuar faktet kontestuese si dhe ka dhënë shpjegime të mjaftueshme për mënyrën e kualifikimit të fakteve në raport me normat materialo-juridike të cilat janë zbatuar në rastin konkret. Kronologjia e arsyetimit të vendimit sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë paraqet një përmbajtje koherente, unike dhe logjike për përfundimin ligjor lidhur me themelësinë e kërkesës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit të parë dhe të paditurit të dytë se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me konstatimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ngase Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, konstaton se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike, me provat e administruara është vërtetuar se paditësi dhe i padituri i parë “Delta Ing” SH.P.K., në vitin 2013 kanë lidhur kontratë me titull “*Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Breznicë lagjja Koskovik dhe në rrugën e fshatit Kozaricë*”, me çmim prej 44,954.29 €, ndërsa me të paditurin e dytë “Bass Com” SH.P.K., në vitin 2013 paditësi ka lidhur kontratë me titullin “*Asfaltimi i rrugëve rurale*”, me çmimin prej 150,232.53 €. Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi detyrimet e tij kontraktuese ndaj të paditurit të parë dhe të dytë i ka përmbushur sipas kontratës, ndërsa i padituri i parë dhe i dytë rezulton se nuk i janë përmbajtur kushteve të parapara me kontratat e lartpërmendura lidhur me asfaltimin e rrugëve, pasi që të njëjtit punimet nuk i kanë realizuar sipas parametrave të parapara me kontratat, e si pasoje e kësaj palës paditëse i është shkaktuar dëm material. Mos përfundimi i punimeve në mënyrë të

rregullt nga i padituri i parë dhe i dytë vërtetohet nga Raportet e punuar nga Instituti i Materialeve Ndërtimore dhe Konstruksioneve N.SH. "IBMS" datë 11.03.2014 te cilat raporte janë bërë me kërkesë të Prokurorisë Themelore ne Prishtinë, në bazë të së cilave rezulton se trashësia e zhavorrit, trashësia e asfaltit dhe kompaktësia mesatare e këtyre rrugëve nuk është punuar në përputhje me kushtet e përcaktuara me kontratat e nënshkruara nga palët ndërgjyese. Në bazë të kontratës dhe ankesë kontratës me nr. të prokurimit 614 12 049 521 "Vazhdimi i asfaltimit të rrugës në fshatin Breznicë lagjja Koskovik dhe në rrugën e fshatit Kozaricë" të lidhur ndërmjet paditësit dhe të padituri të parë "Delta Ing" SH.P.K., shihet se për rrugën e fshatit Kozaricë L-560 m2, është parashikuar shtresa asfalt Beton AB 16 trashësi  $t=7.0$  cm, ndërsa është punuar 4.72 cm, kurse shtresa mbushëse tampon është kërkuar me trashësi  $t=25$ , është punuar  $t=7.18$  cm, dmth jo sipas parametrave të kërkuara sipas paditësit. Kurse në bazë të kontratës dhe ankesë kontratës "Asfaltimi i rrugëve rurale" të lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurit të dytë "Bass Com" me nr. të prokurimit 614 13 014 521, rezulton se ky i fundit ka qenë dashur që trashësinë e asfaltit ta bëjë  $t=8.0$  cm, ndërsa shtresën e zhavorrit 20-30 cm, të përcaktuar sipas masave të caktuara me kontratën dhe ankesë kontratë për rrugët pjesë e këtij projekti, mirëpo i padituri i dytë nuk i është përmbajtur këtyre paramasave duke i bërë me trashësi më të vogël asfaltin dhe zhavorrit. Mos zbatimi i kushteve të kontratave nga të paditurit në mënyrë të detajuar është sqaruar nga N.SH. "IBMS" në raportet e ekzaminimeve kontrolluese të asfaltit për secilën rrugë, e të cilës ekspertizë edhe kjo gjykatë ja falë besimin pasi që është punuar në mënyrë profesionale. Po ashtu edhe ekspertiza e punuar nga eksperti i ndërtimtarisë S.B. është punuar në mënyrë profesionale me anë të së cilës ekspertize konstatohet se i padituri i parë dhe i dytë punët e kryera i kanë bërë me të meta, rrugët e asfaltuar janë dëmtuar për shkak të zvogëlimit të trashësisë së asfaltit të njëjtat nuk janë punuar në përputhje me standardin e ndërtimit (Eurocodin e Kosovës), e njëjta është në përputhje me raportet e lëshuar nga N.SH. "IBMS", e që vërteton në mënyrë të drejtë gjendjen faktike e cila është e pa kontestueshme me rastin e shqyrtimit të provave në fjalë se i padituri i parë dhe i dytë mbajnë përgjegjësi për dëmin material të shkaktuar palës paditëse për shkak të mos përmbushjes së kontratave lidhur me asfaltimin e rrugëve sipas paramasave dhe paralogarisë së kontraktuar, për të cilën përgjegjësi i padituri i parë dhe i dytë janë gjykuar dhe shpallur fajtor me aktgjykim penal të formës së prerë PKR.nr.271/2015 të datës 19. 05.2017.

Me dispozitën e nenit 14 të LPK-së, shprehimisht theksohet: "*Në procedurën kontestimore gjykata, në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit, është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale, me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor*".

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë mori parasysh pretendimet ankimore të autorizuarit të paditurit të dytë lidhur me atë se gjykata nuk ka shqyrtuar drejtë kontratën e lidhur ndërmjet palëve ndërgjyqëse konkretisht nenin 13 që ka të bëjë me korrigjimin e defekteve, mirëpo vlerëson se pretendimi i tillë është i pabazuar, për faktin se duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore pala paditëse me të paditurin e dytë kanë nënshkruar marrëveshje me datë 08.07.2014 për sanimin dëmtimeve në të gjitha rrugët rurale, duke u mbështetur në kontratën nr.XIII – 77, të datës

24.05.2013, sipas së cilës autoriteti kontraktues, i padituri i dytë në bazë të provave shkresore nuk ka vepruar.

Pretendimi ankimor i të paditurit të dytë se kërkesa e shpërblimit të dëmit sipas padisë së ushtruar është parashkruar, sipas vlerësimit të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë është pretendim i pathemeltë ngase kjo gjykatë me shikim në shkresa të lëndës ka konstatuar se paditësi lidhur me rrethanën se kush është fajtor për dëmin e shkaktuar e ka kuptuar pas marrjes së aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR.nr.271/2015 të datës 19.05.2017. Nën rrethanën e tillë kur marrim për bazë kohën, respektivisht datën kur paditësi ka mësuar se kush është fajtor për dëmin e shkaktuar dhe datën e ushtrimit të padisë, kësaj gjykate i ka rezultuar se kërkesa e paditësit për shpërblim të dëmit të kërkuar nuk është parashkruar, e njëjta është paraqitur brenda afatit kohor në kuptim të nenit 357 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së “*Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dajeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin. Në çdo rast kjo kërkesë parashkruhet për pesë (5) vite nga shkaktimi i dëmit*”. Në rastin konkret afati ka filluar të rrjedhë rishtazi nga dita kur aktgjykimi penal me të cilin i padituri i parë dhe i dytë janë shpallë fajtor dhe ka marrë formën e prerë me dt.19.04.2018, ndërsa padia është paraqitur me dt.11.06.2018.

Gjykata Komerciale i ka shqyrtuar të gjitha pretendimet tjera te paditurit te pare se çështje është res-judikata-gje e gjykuar pasi për këtë çështje është vendos me vendimin e Gjykatës Themelore IIIEK nr. 609/2014 dhe i vërtetuar me vendimin A.nr. 213/2016 dt. 25.01.2017. Këto pretendime Kolegji i konsideron si te pabazuar, pasi qe në baze të vendimit të Gjykatës Themelore-Departamentit për Çështje Administrative III.EK nr. 609/2014, padi e paditësit është konsideruar e tërhequr ne baze te nenit 409 te LPK, pasi nuk ka marr pjesë përfaqësuesi i paditësit në seance dhe nuk është vendos ne meritat e çështje ne këtë lende. Rrjedhimisht, me aktvendimin me te cilin është konsideruar padia e tërhequr, konsiderohet sikur te mos ishte paraqitur fare padia, dhe paditësi mund te paraqes përsëri padi te njëjtë për te njëjtën çështje juridike. Padia me te cilin e konsiderohet e tërhequr padia, konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Gjykata e shkallës së dytë ka shqyrtuar pretendimin ankimor të autorizuarit të paditësit, për shpenzimet e procedurës, mirëpo të njëjta i vlerëson si të pabazuar, për faktin se vendimi i gjykatës së shkallës së parë lidhur me shpenzimet e procedurës është i drejtë, pasi që i autorizuari i palës paditëse nuk ka specifikuar shpenzimet, andaj në kuptim të nenit 463.1 të LPK-së, ka qenë dashur të specifikohen nga pala paditëse ashtu që të njëjtat ti kompensohen.

Ankesën e autorizuarit të paditurit të tretë, kjo gjykatë e ka hedhur poshtë si të palejuar, për arsye se me aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë është refuzuar kërkesëpadija ndaj të njëjtit, që nënkupton se i padituri i tretë në rastin konkret nuk ka interes juridik për paraqitjen e ankesës, andaj në kuptim të nenit 186 paragrafi 3 të LPK-së, e njëjta hedhet si e palejuar.

Gjendja faktike në këtë çështje juridike është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, për çka nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurave, për arsye se, gjykata e shkallës së parë në procedurën e të provuarit përmes mjeteve provuese i ka vërtetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për këtë çështje juridike, duke vendosur sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Sipas kolegjit të kësaj gjykate gjendja faktike në këtë procedurë është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ku edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Në këtë kuptim vlerësimet që ka dhënë gjykata e shkallës së parë për bazën juridike të kërkesëpadisë të vërtetuar me aktgjykim penal, me raportet e lëshuara nga instituti N.SH.“IBMS” dhe ekspertizën e ndërtimtarisë, si prova të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i pranon si të tilla edhe kolegji, për të cilën ky është përfundim i drejtë dhe i pranueshëm.

Gjykata Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore të autorizuarit të paditurit të parë dhe të paditurit të dytë mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1608/2022, me datë 15.02.2023.

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari,  
Ramush Bardiqi